



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



DREJTORIA E FINANCAVE

DATA/DATUM/DATE	20.03.2025
NR/BR.01	01 Nr 63/25
PËR/ZA/TO	Komitetin për Politikë dhe Financa Kuvendin e Komunës Ferizaj
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit
NGA/OD/FROM	Agim Aliu, Kryetar i Komunës
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim vendim për bartjen e mjeteve THV nga viti 2024 në vitin 2025

Të nderuar anëtarë të Kuvendit, anëtarë të komitetit për Politikë dhe Financa, organizata jonë buxhetore (656) Komuna e Ferizajt, bazuar në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin nr. 04/L-194 dhe me LIGJI NR. 08/L332 Mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Neni 9 pika 7. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2024 dhe të regjistruara në SIMFK që kalojnë shumat e të hyrave të ndara në tabelën 4.1 për vitin 2024, barten në vitin 2024 me vendim të Kuvendit Komunal

Të hyrat vetanake të vitit 2024 të cilat do të barten në vitin 2025 janë në shumën prej **2,276,658.28€**. Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave, ligjit të buxhetit për vitin 2025 dhe Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nga teprica e mjeteve nga viti paraprak që barten në vitin vijues paguhen obligimet e organizatës buxhetore. Nisur nga kjo, propozimi ynë për shpërndarjen e tyre në kategoritë ekonomike të shpenzimeve dhe në programet buxhetore si vijon:

Kategorit ekonomike:

Mallra dhe shërbime 950,731.28€
Subvencione dhe transfere 744,000.00€
Investimet kapitale 431,927.00€
Shpenzimet komunale 150,000.00€

Në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime:

Administrata (16332) shuma prej 250,000.00 €
Tatimi në pronë (17572) shuma prej 200,731.28€
Kujdesi primar shëndetësor (74900) shuma prej 250,000.00€
Administrata e arsimit (92160) shuma prej 250,000.00€

Në kategorinë e shpenzimeve komunale:

Administrata (16332) shuma prej 150,000.00€

Në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere:

Zyra e kryetarit (16032) shuma prej 100.000.00€
Administrata e shëndetësisë (73041) shuma 94,000.00€
Administrata e arsimit (92160) shuma prej 550,000.00€

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:

Infrastruktura rrugore (18032) Shuma prej 100.000.00€ në projektin me kod **88773** Shtrurja e rrugeve me zhavor - hapja e rrugeve te reja

Infrastruktura publike (18192) në shuma prej 50,000.00€ në projektin me kod **53029** Rregullimi i shtreterve te lumenjeve dhe kanaleve ujore ne Talinovc, Koshare, Terrn , Pleshine, Greme, Gaçkë

Turizmi (48072) shuma prej 241,927.00€ në projektin me kod **53097** Ndertimi I infrastruktures se zonave turistike ne Jezerc

Kultura, rinia dhe sportet (85112) shuma prej 40,000.00€ në projektin me kod **54782** Ndërtimi I tribunave në stadiumin Tefik Çanga në fshatin Tërrn

Arësytet :

Kërkesa për bartje e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025 të bërë nga Kuvendi Komunal i Ferizajt , ka ndryshim në strukturën e shpenzimeve. Po ashtu komuna e Ferizajt në vitin 2024 ka tejkallim të planit të të hyrave vetanake, në shumë prej **2,276,658.28** €, ku këto mjete do të barten në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime në shumë prej 1,100,731.28€, subvencione dhe transfere ne shumë prej 744,000.00 €, dhe në kategorin e shpenzimeve kapitale në shumë prej 431,927 €, këto mjete barten për mbulimin e obligimeve kontraktuale të pa paguara..